REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 115/17
Datë/Datum. 20.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **(KOMUNA E KLINËS)**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **(634-17-455-221)**

Sa i përket tenderit për **(PËRGATITJA E PROJEKTEVE EKZEKUTIVE PËR RRUGE)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.N INFRA PLUS
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
RR.LUAN HARADINAJ SOL.1 H.1 PRISHTINË; NJËSIA LLAPNASELLË
(Adresa)

PRISHTINË
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

+381 38 606262
(Numri Telefonit)

600074158
(Numri i Faks-it)

Musa ISLAMAJ
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
info@infraplus-ks.com
(Adresa elektronike)

20/04/2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

PROJEKTIM & NDERTIM N.N. Infra-Plus CONSULTING & ENGINEERING

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Pas publikimit të aktivitetit të prokurimit me titull **"PERGADITJA EPROJEKTEVE EKZEKUTIVE PER RRUGE "** nga Komuna e Klinës ne kemi marrë pjesë në tender.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

Me datë 28.02.2017 është publikuar njoftimi për kontratë ndërsa me datë 13.03.2017 është bërë hapja publike e ofertave dhe në bazë të raportit të hapjes publike shihet se ne jemi të vetmit ofertues te cilët kemi dorëzuar ofertën per e-prokurimit dhe ne bazë te njoftimit për eliminim ne trajtohemi te papërgjegjshëm, dhe njëkohësisht brenda afati kohor te përcaktuar me ligj kemi dorëzuar ankesën për rishqyrtim të vendimit të AK-se por është refuzuar andaj do ta ngritim çështjen në OSHP.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Ne përputhje me nenin108/A kemi parashtruar kërkesë ne AK per rishqyrtim te vendimit , por nje kërkesë e tille nuk ka gjetur mirëkuptim.

Pasi kemi dorëzuar kërkesën ne AK jemi informuar se brenda 2 dite duhet plotësuar kërkesën per rishqyrtim, dhe pas plotësimit ne kemi pranuar nje vendim i cili per ne është krejtësisht i paqarte, qa do te thotë se ankesa jone nuk është marrë për bazë , dhe si rezultat i kësaj i drejtohemi OSHP-së me ankesë kundër AK-Komuna Kline pas eliminimit tonë në mënyre jo te drejte pasi qe nje kërkesë e tille e AK per sigurim te ofertës ka qene dashur te vendoset ne dosje te tenderit sepse Autoritet Kontraktuese gjatë zbatimit te procedurave duhet referuar kërkesave te ligjit dhe udhëzuesit ne kërkesat te dosjes apo njoftimit per kontrate .

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ne tenderin e e publikuar me **titull "PERGADITJA E PROJEKTEVE ZBATUESE PER RRUGE** me nr. prokurimi **634-17-455-231** nuk ka respektuar dispozitat ligjore si ne vijim:

- Nenit 7 barazia ne trajtim
- Nenin 51 njoftimi i kritereve te përzgjedhjes
- Nenin 52 kriteri per vlerësim
- Neni 59 vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK me rastin e këtij tenderi nuk ka bërë vlerësim te drejtë dhe me këtë rast ka bërë diskriminim për arsye se nuk iu ka përmbajtur kritereve të përcaktuar në njoftim për kontrate dhe dosje te tenderit .

Me date 06.04.2017 kemi pranuar njoftimin për eliminim nga AK –Komuna Klinë ku ne na trajton te papërgjegjshëm duke u BAZUAR NE PIKEN 29.13 E Udhëzuesit te Prokurimit publik specifikon , mirëpo AK duhet pasur te qarte se kërkesa e tille duhet te vendoset ne njoftim per kontrate apo dosje te tenderit.

Ne si OE pjesëmarrës jemi te obliguar qe ti respektojmë kërkesat e dosjes ndera Udhëzuesin per prokurim publik duhet zbatuar Autoriteti kontraktues qa do te thotë se çdo kërkesë qe është relevante per autoritetin kontraktues lidhur me nje procedure te zbatuar është e domosdoshme qe kërkesat e Ligjit per Prokurim Publik si dhe te Udhëzuesit per Prokurim publik ti inkorporoj ne dosje qa do te thotë se edhe nje kërkesë te tille e AK-se është dashur ta vendoset ne dosje te tenderit dhe ne njoftim per kontrate.

Duke i referuar nenit 57 pika 3 te LPP-se nëse autoriteti kontraktues vendos depozitimin e sigurisë së tenderit, shuma e sigurisë së tillë duhet të jetë jo më pak se një për qind (1%) dhe jo më shumë se tre për qind (3%) e vlerës së parashikuar të kontratës publike ose konkursit të projektimit, por sidoqoftë, në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se njëmijë (1.000) Euro." Dhe me pas vijon pasusi tjetër i këtij nenin përkatësisht paragrafi 4 sipas se cilit

Nëse autoriteti kontraktues vendos kusht për sigurim të tenderit, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit të gjitha kushtet në lidhje me natyrën, formën, shumën si dhe kushtet e tjera për sigurinë e tenderit, me kusht që, të gjitha kushtet e tilla të jenë në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e prokurimit publik qa do te thotë se është dashur te vendoset edhe kërkesa e nenit 29 paragrafi 13 i Udhëzuesit per Prokurim Publik.

KK Kline është i vetmi Autoritet Kontraktues i cili na ka eleminuar per shkak se sigurimi nuk është sjell ne kopje fizike dhe sikur nje kerkese e tille ne te cilën thirret Autoriteti Kontraktues do ta kishim te qarte, ne do ta dorëzonim mirëpo ne gjë e tille nuk eshte theksuar ne dosje te tenderit.

Duke i referuar dorëzimit te ofertës përmes e-prokurmit përveç sigurimit te ofertës njëkohësisht edhe formulari i tenderit dhe deklarata nen betim si dhe te gjitha dokument tjera te dorëzuara ne oferte janë te skanuara pasi qe momentalisht nuk ekziston mundësia e e nënshkrimit digjital dhe nëse e marrim per baze kete çdo oferte qe dorëzohet

përmes e-prokurimit duhet shpallur te papërgjegjshme pasi qe ligjërisht formulari i tenderi duhet te jete i nënshkruar dhe i vulosur ne forme origjinale.

- Mos respektim te nenit 51 te Ligjit sipas se cilit Autoriteti kontaktues duhet: (i) të përcaktojë në njoftimin e kontratës, aq sa është e mundshme, të gjitha dokumentet dhe informatat e tjera që operatorët e interesuar ekonomik qe duhet të dorëzojnë së bashku me tenderin

- AK ka bere mos respektim te nenit 59 te LPP-se per arsye se sipas paragrafit 4 te keti neni Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, andaj ne kemi plotësuar çdo kërkesë te dosjes dhe te njoftimit, por edhe per kundër kësaj AK ne përputhje me nenin 72 te LPP-se paragrafi 4 ofrimi i informacioni do te aplikohet per dokumentet ekzistenca e te cilave eshte para skadimi te afatit per dorëzim te ofertave te tenderëve.

- AK nuk ka respektua nenin 52 kriterin per dhënie te kontratës pasi qe ne jemi ofertuesi i pare qe kemi dorëzuar tenderin dhe njëkohësisht kemi çmim te barabarte me ofertuesin e rekomanduar per kontrate.
-

Duke i referuar çështjeve te ngritura me lart rekomandoj OSHP-ne qe lenden ta kthej ne Rivlersim dhe te detyroj autoritetin kontraktues ta anuloj njoftimin per dhënie pasi qe ne na eliminon nga konkurrenca per nje kërkesë e cila nuk ka qen ne dosje te tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*